



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun
Subjekti: Njoftim

Prishtinë, 03.05.2008

Njoftim

Të shtunën, me 03.05.2008, Kryetari i Komunës së Preshevës dhe Lideri i Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa, vizitoj Aleancën Kosova e Re, ku u prit nga nënkryetarët e kësaj partie Ibrahim Gashi dhe Ibrahim Makolli, nga Sekretari i Përgjithshëm Avdi Smajlaj dhe Shefi i Protokollit Shpend Kallaba.

Kryetari i Komunës së Preshevës z. Ragmi Mustafa gjatë takimit shprehi shqetësimin për gjendjen e krijuar në Preshevë, me theks të veçantë në vijën kufitare me Kosovën. Ai tha se kontrolli i madh kufitar nga forcat serbe nuk po i kontribuon stabilitetit, por përkundrazi kjo po krijon një gjendje të tensionuar në vazhdimësi. Z. Mustafa shtoi se ky kontroll i madh dhe veprimet e forcave serbe janë provokuese dhe po përcillen me incidente të kohëpaskohshme.

Përveç tjerash, z. Mustafa, theksoj faktin se Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) që udhëhiqet nga ai, do të marrë pjesë në zgjedhjet lokale serbe, sepse, sipas tij, kjo është zgjidhja e duhur në këtë kohë. Ai shtoi se duke marrë pjesë në zgjedhjet lokale serbe, shqiptarët në Luginën e Preshevës, mund të faktorizohen më shumë. Z. Mustafa tha se do t'u bëjë thirrje të gjithë shqiptarëve të Preshevës që jetojnë në Kosovë, që të marrin pjesë në këto zgjedhje.

Ndërkaq, Nënkyetari, Ibrahim Gashi duke i dëshiruar mirëseardhjen, z. Mustafës, i garantoj atij mbështetje të pakursyer nga Aleanca Kosova e Re. Ai tha se gjendja e krijuar është shqetësuese, por nënvizoj faktin se realiteti i ri në Kosovë, ka reflektuar në vazhdimësi për shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës. Z. Gashi, vlerësoj lartë qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare, në gjithë këtë proces, në veçanti ndikimin që po ushtrojnë ato, ndaj udhëheqësve serb, për të hequr përfundimisht dorë nga Kosova dhe që t'i kthehen realitetit të ri, të krijuar në Serbi. Ai tha se mbështet vendimin për pjesëmarrje të PDSH-së në zgjedhje lokale, duke e konsideruar atë, si një vendim të arsyeshëm.

Ndërsa Nënkyetari Ibrahim Makolli, e vlerësoj si inkurajues faktin se PDSH do të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të Serbisë. Ai shprehi mendimin, se çështja e Preshevës dhe e shqiptarëve që jetojnë në Serbi duhet të merret shumë më seriozisht se deri tash. Ndër të tjera ai tha, se ka ardhur koha që shqiptarët e Luginës së Preshevës të kërkojnë fuqishëm të drejtat e tyre. “Përderisa serbëve në Kosovë iu krijohen të gjitha kushtet e nevojshme për mirëqenie dhe trajtohen në mënyrë specifike, duhet patjetër që edhe shqiptarët që jetojnë në Serbi të kenë të drejta të barabarta dhe t'u krijohen kushte për të pasur një jetë më të mirë” – tha z. Makolli, gjatë takimit me Kryetarin e Komunës së Preshevës, z. Ragmi Mustafën.